

Prof. Dr. Ymer JAKA

PORTRETI I AHMET KORENICËS NË DRAMËN “BESA E MADHE” TË MIROSH MARKAJT

Që nga kohët më të lashta një pjesë e letërsisë mbështetjen e vet e ka gjetur në histori. Shumë shkrimtarë, që nga Homeri e deri në ditët e sotme, janë frymëzuar nga ngjarje të ndryshme historike dhe i kanë përjetësuar ato në veprat e tyre. Kur bëhet fjalë për frymëzimin nga historia, kjo nuk do të thotë se shkrimtari bën punën e historianit. Ky i fundit, duke u mbështetur në të dhëna të dokumentuara, e rindërton të kaluarën të atillë çfarë ka qenë. Për shkrimtarin, ndërkaq, historia është shumë shpesh vetëm një pikënisje për t'i dhënë krahe imagjinatës së tij dhe për ta dhënë një vizion të së kaluarës, plot ngjyra e nuanca, të cilat atë të kaluar na e bëjnë më të gjallë, më të afërt dhe më konkrete. Madje nuk ndodh rrallë që vizioni për të kaluarën të publiku i gjerë të krijohet më shumë nga leximi i veprave letrare sesa nga ai i veprave historike.

Sikundër në letërsitë e tjera, edhe në letërsinë shqiptare ndeshim një varg shkrimtarësh të cilët lëndën e veprave të tyre e kanë gjetur në histori. Njëra ndër këto vepra është edhe drama *Besa e Madhe* e Mirosh Markajt, e cila u shkrua dhe u vu në skenë me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, pra më 1978.¹ Në këtë dramë trajtohet njëra ndër ngjarjet kryesore të kësaj Lidhje, vrasja e Mehmet Ali pashë Maxharit në Gjakovë.

Derisa në shumë vepra me tematikë historike personazhet e tyre janë pjellë e imagjinatës së autorit, pra janë personazhe të panjohura në histori, për dramën *Besa e Madhe* kryepersonazhet janë personalitete të njohura historike si Mehmet Ali pashë Maxhari, Abdulla pashë Dreni, Sulejman Vokshi, Ahmet Korenica, Prenkë Gulia, Mic Sokoli, Ali pashë Gucia, Shaqir Curri, Hasan Batusha dhe disa personalitete më pak të njohura, krahas atyre që janë pjellë e imagjinatës së autorit, të cilat i janë dashur për zhvillimin e veprimit të dramës.

¹ Mirosh Markaj, *Besa e Madhe*, Prishtinë, Gjon Buzuku, 1990. 108 f.

Njëri ndër personazhet e dramës, madje i dyti me radhë në radhitjen e personazheve të veprës, menjëherë pas Sulejman Vokshit, është personaliteti i njohur i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Ahmet Korenica, i cili luajti rol të rëndësishëm në ngjarjet e zhvilluara në Gjakovë në shtatorin e vitit 1878, kur iu bë me dije Perandorisë Osmane se shqiptarët nuk ishin monedhë këmbimi.

Në këtë punim do të bëjmë fjalë për portretin e Ahmet Korenicës në dramën e Mirosh Markajt *Besa e Madhe*.

Autori i kësaj vepre për dy ndër kryepersonazhet e dramës së tij, Sulejman Vokshin dhe Ahmet Korenicën, përdor shkurtime të emrave të tyre, të parin e emërton Sulë Vokshi, ndërsa të dytin Met Korenica. Për këto shkurtime nuk kemi të dhëna se a janë përdorur për të gjallë të tyre, mbase autori i ka gjetur në dokumentet arkivale të cilat i ka pasur në dorë, ose ato janë pjellë e imagjinatës së tij.

Ahmet Korenica është i pranishëm në dramën *Besa e Madhe* që nga akti i saj i parë deri në aktin e fundit, qoftë duke e vënë këtë personazh në skenë drejtpërdrejt, qoftë tërthorazi, duke bërë fjalë për personazhet e tjera të dramës.

Për herë të parë, në aktin e parë të dramës, për Ahmet Korenicën flet njëri ndër muhaxherët që janë vënë në skenë,² Mujë Muhaxhiri, i cili tregon se në saje të ndihmës së hoxhë Korenicës ai e kishte siguruar kulmin mbi kokë për familjen e tij në Gjakovë.³ Pak më vonë, gjithnjë në aktin e parë, në skenë del vetë Ahmet Korenica, i cili kishte dalë te Ura e Fshejtë ta priste Sulejman Vokshin që kthehej nga Prizreni, ku kishte arritur Ali pashë Maxhari. Pasi mëson nga Sulejman Vokshi se Mehmet Maxhar Pasha kishte ardhur në Kosovë që ta zbatonte vendimin e sulltanit për t'ia dorëzuar Plavën e Gucinë Malit të Zi, reagimi i Ahmet Korenicës është që kjo punë nuk do të bëhet: «Kurrën e kurrës»,⁴ ndërsa kur kupton se kryetari i degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Gjakovë, Abdulla pashë Dreni, i ishte bërë krah Maxhar Pashës, Ahmet Korenica e jep këtë vlerësim për Abdulla Drenin: «Unë nuk çuditem, or miq e shokë, Abdulla Dreni i kanë pëlqyer gjithmonë nishanet. Ai i ka pritur me dorë në zemër të gjitha fermanet e padishahut, ndryshe nuk bëhej pashë, por dilte kaçak malit si ti, Sulejman agë Vokshi».⁵ Ndërkaq, kur telalli del t'ia kumtojë popullit lajmin për ardhjen e Maxhar Pashës në Gjakovë, Ahmet Korenica ia rrëmben daullen

² Sipas të dhënave historike në Gjakovë kishin ardhur rreth tri mijë muhaxherë, të dëbuar nga Nishi, Vraja, Tivari dhe vende të tjera në kohën e Lidhjes së Prizrenit, kur Serbia kishte ndërmarrë pastrimin etnik të trojeve shqiptare.

³ Mirosh Markaj, *Besa e Madhe*, f. 10.

⁴ *Po aty*, f. 17.

⁵ *Po aty*, f. 18.

dhe jep kushtimin që të mblidhet «trimëria e Gjakovës» për t’iu kundërvënë misionit të të dërguarit të sulltanit.⁶

Në aktin e dytë autori nuk e ka vënë në skenë Ahmet Korenicën, por për të bëhet fjalë disa herë në këtë akt, kur flitet për nxënësit që e mësojnë shqipen me shkronja latine nga Toni i Prenkës, për rrugën e tradhtisë së Abdulla Drenit,⁷ ndërsa në dialog me Patër Pjetrin, pohimit të priftit se «qeveria e Stambollit nuk i lejon shkollat shqipe», Prenkë Gulia i përgjigjet: «Në Prizren e në Gjakovë hyqymet e dovetlet është Lidhja Shqiptare, tha Met Korenica».⁸

Në aktin e tretë, krahas emrit të Ahmet Korenicës gjendet edhe epiteti i tij «kadiu i Gjakovës»,⁹ ai cilësohet si njëri ndër krerët e qytetit kur ftohet në sarajin e Abdulla Drenit për të biseduar me Maxhar Pashën.¹⁰ Në këtë bisedë, bashkë me Sulejman Vokshin, ai i kundërvihet pa u trembur kërkesës së Maxhar Pashës që t’i dorëzohet Plava e Gucia Malit të Zi. Ahmet Korenica, ndër të tjera, i përgjigjet shkoqur të dërguarit të sulltanit: «Ne e kuptojmë fare mirë se kështu si i keni nisur pazarllëqet me Evropën, do të na e shisni tërë Shqipërinë».¹¹ Gjatë këtij dialogu Ahmet Korenica nuk ngurron ta cilësojë Maxhar Pashën «armik të Shqipërisë»,¹² ndërsa duke parë se Abdulla Dreni kurrësi nuk e pranonte kërkesën e krerëve të Gjakovës për ta dëbuar nga shtëpia e tij Maxhar Pashën, Ahmet Korenica propozon t’i jepej fund kësaj bisede me fjalët: «Këtu duhet të kërcasë huta».¹³

Në aktin e katërt Ahmet Korenica me Tonin e Prenkës diskutojnë se si lutjet fetare duhet të bëhen jo në gjuhën arabe, por në atë gjuhë që e kupton populli, të cilën, siç na del nga drama *Besa e Madhe*, Ahmet Korenica jo vetëm që e fliste, punë kjo e natyrshme, por edhe e shkruante.¹⁴ Nga ana tjetër, temë diskutimi është edhe se si të bashkoheshin fetë e ndryshme në Shqipëri.¹⁵ Duhet shtuar këtu se në këtë vepër dija herë recitohen vargje nga poezia e njohur e Pashko Vasës *O moj Shqypni*.¹⁶ Në fund të këtij akti Toni i

⁶ *Po ary*.

⁷ *Po ary*, f. 29, 32, 34.

⁸ *Po ary*, f. 35.

⁹ *Po ary*, f. 38.

¹⁰ *Po ary*, f. 41.

¹¹ *Po ary*, f.46.

¹² *Po ary*, f. 49.

¹³ *Po ary*, f. 50.

¹⁴ *Po ary*, f. 68.

¹⁵ *Po ary*, f. 70.

¹⁶ *Po ary*, f. 27, 70, 89, 90.

Prenkës e cilëson Ahmet Korenicën «prijës të vërtetë të malësorëve dhe fusharakëve tanë».¹⁷

Në aktin e pestë, të fundit, Ahmet Korenica është ai që jep kushtrimin për ta nisur sulmin kundër Maxhar Pashës dhe atyre që i kishin dalë krah në sarajin e Abdulla Drenit: «Të lidhim besën, o burra! Asnjë tradhtar të mos dalë i gjallë nga sarajet. Rruga jonë për në Plavë e Guci shkon nëpër sarajet e Abdulla Drenit. Fjala-fjalë e besa-besë!» deklaroi ai.¹⁸

Në dramën *Besa e Madhe* Ahmet Korenica na del një personalitet kompleks, atdhetar i paepur, syptrembur, i vendosur të luftojë deri në fund për çështjen kombëtare. Ai është i vetëdijshëm se liria nuk fitohet pa sakrificë, se shqiptarët mund ta flakin zgjedhën shumëshkullore osmane vetëm të bashkuar dhe të organizuar ashtu si duhet. Ndonëse është kadi, klerik i shkolluar dhe me kulturë të gjerë, prandaj edhe gëzon autoritet të madh në qytetin ku jeton, ai është burrë i thjeshtë, gjithnjë është midis popullit, i ndan me të të mirat dhe të ligat. Nëpërmjet angazhimit personal për çështjen kombëtare, ai jep shembull se si duhet të mbrohet atdheu. Maxhar Pashës i thotë haptas se është armik i shqiptarëve dhe se ky popull është i vendosur ta mbrojë me gjak tërësinë e trojeve të veta. Në fund të dramës Ahmet Korenica është ai që e jep kushtrimin për sulmin në sarajin e Abdulla Drenit, me ç'rast vritet Maxhar Pasha dhe ata që vajtën ta mbronin, ngjarje kjo që i tregoi botës se shqiptarët ishin të gatshëm t'u kundërviheshin me çdo çmim orvatjeve të fuqive të mëdha për copëtimin e trojeve të tyre dhe se vendimet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nuk ishin vetëm vendime të qitura në letër, por vendime të cilat do të zbatoheshin në praktikë, si udhërrëfim për ta flakur një herë e përgjithmonë zgjedhën osmane.

Një formulim, i vënë në gojën e njërit ndër protagonistët e dramës, i cili thotë se «hoxhë Met Korenica është edhe i divitit, edhe i gishtit»,¹⁹ pra edhe i penës edhe i pushkës, e pasqyron në mënyrë figurative personalitetin e Ahmet Korenicës. Ka të ngjarë se autori i dramës, Mirosh Markaj, sigurisht pas konsultimit të dokumenteve arkivore për këtë personalitet, i cili me veprimtarinë e tij patriotike zë një vend të shquar në historinë tonë të gjysmës së dytë të shekullit XIX, në veçanti të periudhës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, është magjepsur me luftën e tij për mbrojtjen e atdheut dhe portetin e tij e ka skalitur me përkushtim të posaçëm.

Personazhi i Ahmet Korenicës në dramën *Besa e Madhe* është një paraqitje e gjallë e atij personaliteti çfarë e njohim nga historia. Ndonëse imagjinata e autorit të kësaj vepre pa dyshim ka luajtur rol në portretimin e

¹⁷ *Po aty*, f. 81.

¹⁸ *Po aty*, f. 88-89.

¹⁹ *Po aty*, f. 71.

këtij personaliteti, ai megjithatë ruan konturat kryesore të personalitetit të vërtetë historik, prandaj shpresojmë se me këtë kumtesë tonën modeste kemi dhënë një ndihmesë për ndriçimin e gjithanshëm të jetës dhe të veprës së Ahmet Korenicës.

Prof. Dr. Ymer JAKA

PORTRAIT OF AHMET KORENICA IN THE *BESA E MADHE* (GREAT PLEDGE)
PLAY BY MIROSH MARKAJ

Summary

The character of Ahmet Korenica in the play called *Besa e Madhe* is a lively presentation of the personality as he has been known by history. Although author's imagination in this work has played a role in creating the portrait of this character, he nevertheless keeps the main features of the true personality. Therefore, we hope that this humble paper will bring a contribution to throwing light on the life and work of Ahmet Korenica.

